



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2780/3 Prot.

Tiranë, më 21.09.2023

V E N D I M

Nr. 58, datë 21.09.2023

PËR

**“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 63, DATË 08.10.2021 PËR “MIRATIMIN E KRITEREVE TË PUNËSIMIT TË PERSONELIT ADMINISTRATIV TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 116; në Kodin e Procedurave Administrative në RSh, neni 112; në ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 11, pika 2, shkronjat “b” dhe “c”; në Statutin e UMT-së, neni 53; në Rregulloren e UMT-së, neni 34, shkronja “a”, si dhe në shkresat nr. 1714/6 prot., datë 29.06.2023 dhe nr. 1714/7 prot., datë 16.08.2023 të Administratorit të UMT-së, në mbledhjen e datës 21.09.2023, Bordi i Administrimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

- Në Seksionin I të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 63, datë 08.10.2021 për “Miratimin e kriterëve të punësimit të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” bëhen këto ndryshime:
  - Pika 12, Kriterë, shkronja “b” ndryshon si më poshtë:  
“Drejtuësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm duhet të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion, nga të cilat jo më pak se 3 vjet në fushën e auditimit, dhe të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”;
  - Pika 13, Kriterë, shkronja “b” ndryshon si më poshtë:  
“Audituesi i brendshëm duhet të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në profesion dhe të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.
- Ngarkohet Administratori i UMT-së për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR  
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ